



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 434/Prot.

Tiranë, më 02/9/2015

REKOMANDIM

Nr. 33 / datë 02/9 /2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, pas kontrollit të ushtruar në ngarkim të kontrolluesit "*Phonext sh.p.k*",

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 103, datë 15/05/2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Phonext sh.p.k*" me objekt:

- *Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Phonext sh.p.k", të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.*

Kontrolluesi "*Phonext sh.p.k*" (NIPT: L317290020) është person juridik jopublik, që operon në fushën e veprimtarisë Call Center. Phonext është i specializuar për të ofruar shërbime marketingu outbound dhe inbound. Mjetet e kryerjes së aktivitetit janë telemarketingu, e-mail marketing dhe mobile marketing. Kontrolluesi ka si klientë kompani italiane dhe gjatë shërbimeve që ofron kontakton vetëm me shtetas italianë. Gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi përpunon të dhëna personale të punonjësve (shtetas shqiptarë) dhe të dhëna personale të klientëve (shtetas italianë).

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi "*Phonext sh.p.k*" bashkëpunon me kompaninë italiane "*Infoimpresa srl*", rezidente ligjore në Mesina (Itali). Kjo marrëdhënie është e sanksionuar nëpërmjet një kontrate shërbimi në të cilën parashikohet veprimtaria që duhet të kryejë kontrolluesi "*Phonext sh.p.k*" për llogari të kompanisë italiane "*Infoimpresa srl*". Lista e klientëve italianë sigurohet nga kompania italiane e cila përcakton në kontratë edhe kushtet e përpunimit të të dhënave nga "*Phonext sh.p.k*", detyrimet e ruajtjes së konfidencialitetit dhe masat e sigurisë për përpunimin e të dhënave personale (parashikuar në pikën 10 dhe 11 të kontratës).

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi "*Phonext sh.p.k*" disponon sisteme informatike dhe elektronike me qëllim automatizimin e proceseve të përpunimit të të dhënave dhe proceseve të punës. Në përmbushje të proceseve të punës, "*Phonext sh.p.k*" disponon sisteme elektronike si servera, kompjutera, fireçall, sistemin e video survejimit, sistemin e telefonisë VICIDIAL, portalin www.phonext.al, sistem alarmi etj.

Sa i përket projektimit, instalimit, administrimit dhe sigurisë së pajisjeve kompjuterike, sistemeve informatike dhe të dhënave që ato bartin, rrjetit të brendshëm dhe vazhdueshmërisë së punës në raste shkatërrimit të të dhënave apo sistemeve në mënyrë aksidentale apo të qëllimshme, kontrolluesi “Phonext sh.p.k” ja ka deleguar këto shërbime subjektit “IMPULS Studio”. Kontrolluesi “Phonext sh.p.k”, disponon politika dhe rregullore lidhur me përdorimin e sistemeve të informacionit dhe komunikimit. Midis “Phonext sh.p.k” dhe subjektit “IMPULS Studio” është nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti. Në këtë marrëveshje janë përcaktuar delegimet e proceseve që duhet të realizojë “IMPULS Studio” si palë e kontraktuar dhe ruajtjen e konfidencialitetit për shkak të aksesit në sisteme dhe të dhënat e Subjektit “Phonext sh.p.k” (në zbatim edhe të nenit 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”).

Zyra e Komisionerit konstaton se për kategorinë “punonjës”, gjatë aktivitetit të tij, kontrolluesi mbledh të dhëna personale si: *emri, mbiemri, data e lindjes, vendi i lindjes, gjinia, moshë, numri i telefonit, profesioni, gjendja shëndetësore e aftësisë për punë*, etj. Këto të dhëna mblidhen nëpërmjet dokumenteve të domosdoshme për tu paraqitur të tilla si, fotokopja e kartës së ID, librezës së punës, raportit mjeko-ligjor, kontratës së punës, deklaratës së përgjegjësisë civile dhe penale dhe librezës së sigurimeve shoqërore. Këto dokumente administrohen në dosjen personale të punonjësit në përputhje me kodin e punës.

Nëpërmjet “Deklaratës së përgjegjësisë civile dhe penale” dhe “Marrëveshjes së konfidencialitetit”, punonjësi merr përsipër detyrimin që të ruajë konfidencialitetin e të dhënave të klientëve me të cilat njihet gjatë procesit të punës. Ky detyrim vazhdon edhe pas shkëputjes së marrëdhënies së punës.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887, dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi, Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në procesverbalin e hetimit (datë 29.06.2015), konstatoi se:

1. Kontrolluesi, në aktet e brendshme organizative, aktet që sanksionojnë marrëdhënien me punonjësit dhe aktet lidhur me rregullat e përpunimit të të dhënave personale, nuk ka parashikuar një afat konkret lidhur me mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale të punonjësve (të administruara në dosjet e punës nga burimet njerëzore), pas përfundimit të marrëdhënies së punës, në kundërshtim të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08/09/2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”;
2. Kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimin e parashikuar në nenin 18/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, sa i përket:
 - Informimit të punonjësve (në cilësinë e subjektit të të dhënave personale) lidhur me fushën dhe qëllimin, për të cilin përpunohen të dhënat personale, personin që do të përpunojë të dhënat, mënyrën e përpunimit dhe të drejtat që gëzojnë në kuadër të ligjit për mbrojtjen e të dhënave;
 - Publikimit të “politikave të privatësisë” në faqen/web-sitin (www.phonext.al) të administruar prej tij, me qëllim informimin e çdo personi që viziton faqen (subjekt i të dhënave personale ose jo), mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, masat e marra për sigurinë e të dhënave personale si dhe të drejtat e subjekteve të

të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Në këtë kuadër subjektet e të dhënave janë privuar nga e drejta për informim;

3. Në kuadër të zbatimit të Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar:

- Tabelat informuese për kamerat nuk janë hartuar sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin nr. 3, pasi nuk e informojnë subjektin e të dhënave mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre të sanksionuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe nuk i jep mundësinë për të kontaktuar me kontrolluesin nëpërmjet numrit të telefonit;
- Nuk është marrë pëlqimi/miratimi i 75% të banorëve të pallatit për përdorimin e sistemit CCTV në godinën e pallatit/ambientet e përbashkëta; (referuar pikës 5/b të Udhëzimit nr. 3)
- Kamerat 01 dhe 02 janë të pozicionuara në ambientet e punës së punonjësve duke cënuar privatësinë e punonjësve gjatë ushtrimit të funksionit. (Bazuar edhe në Udhëzimin nr. 11, datë 08/09.2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, pika 10.2 “Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës”). Kamerat 03 dhe 04 janë të drejtuara nga rruga dhe regjistrojnë kalimtarët dhe mjetet automobilistike. Në këtë kuadër përpunimi i të dhënave është në tejkalim të qëllimit të përpunimit që është siguria e objektit (referuar nenit 5/1/b të ligjit nr.9887). Kamerat duhet të fokusohen vetëm nga fasada e godinës dhe hyrja e kompanisë.

4. Kontrolluesi në kontratën e punës me punonjësit dhe deklaratën e konfidencialitetit i referohet legjislacionit italian për mbrojtjen e të dhënave personale, pavarësisht faktit që përpunimin e të dhënave dhe veprimtarinë e kryen në territorin e Shqipërisë.

Në lidhje me këto konstatime kontrolluesi ka paraqitur pretendimet dhe dokumentet përkatëse nëpërmjet shkresës nr. 434/2 prot, datë 03.07.2015. Gjithashtu janë paraqitur dokumente mbi masat e marra nga kontrolluesi edhe në seancën dëgjimore të datës 21.07.2015. Seanca dëgjimore është realizuar nga Zyra e Komisionerit në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Zyra e Komisionerit, pasi analizoi pretendimet dhe dokumentet e paraqitura nga kontrolluesi vlerëson se:

- Kontrolluesi, në “Kontratën e Punës tip” që sanksionon marrëdhënien me punonjësit ka parashikuar një afat konkret prej 20 ditësh, lidhur me mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale të punonjësve (të administruara në dosjet e punës nga burimet njerëzore), pas përfundimit të marrëdhënies së punës, në kuadër të respektimit të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08/09/2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”;

Nga analizimi i akteve rezulton që nuk është përcaktuar qëllimi i mbajtjes së të dhënave të punonjësve pas përfundimit të marrëdhënies së punës por është parashikuar qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Informimi mbi qëllimin e mbajtjes së të dhënave është i rëndësishëm në kuadër të transparencës së kontrolluesit.

- Janë ndërmarrë hapa konkretë në kuadër të respektimit të detyrimeve të parashikuara në nenin 18/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Në këtë kuadër kontrolluesi ka hartuar formularin “E drejta e Informimit dhe Mbrojtjes së të dhënave personale”, i cili nënshkruhet nga çdo punonjës.

Nga analizimi i tij rezulton se informimi nuk është i plotë dhe në to nuk janë përfshirë dispozita mbi masat konkrete të sigurisë që ndërmerr kontrolluesi dhe proceset e përpunimit të të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se njohja e subjekteve të të dhënave me këto masa garanton siguri maksimale gjatë përpunimit dhe transparencë, me qëllimin ushtrimin real të të drejtave nga ana e subjekteve të të dhënave.

Një rol të rëndësishëm luajnë edhe “Politikat e privatësisë” të publikuara në faqet e internetit të kontrolluesve. Është e rëndësishme që të kuptohet se roli informues i “Politikave të privatësisë” duhet të përfshijë çdo kategori të dhëne personale dhe çdo subjekt të të dhënave, pra qoftë për të dhënat që përpunohen manualisht qoftë për ato që përpunohen elektronikisht. Gjithashtu është e nevojshme që të parashikohen masat konkrete të sigurisë që kontrolluesi ndërmerr gjatë dhe pas përpunimit të të dhënave.

- Në kuadër të zbatimit të nenit 27 të ligjit nr. 9887 dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar, kontrolluesi ka përgatitur “tabelën informuese për kamerat” sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin nr. 3 dhe gjithashtu ka marrë pëlqimin/miratimin e 75% të banorëve të pallatit për përdorimin e sistemit CCTV në godinën e pallatit/ambientet e përbashkëta (referuar pikës 5/b të Udhëzimit nr. 3).

Zyra e Komisionerit konstaton se Kameran 01 dhe 02 janë të pozicionuara në ambientet e punës së punonjësve duke cënuar privatësinë e punonjësve gjatë ushtrimit të funksionit. (Bazuar edhe në Udhëzimin nr. 11, datë 08/09.2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, pika 10.2 “*Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës*”).

Kameran 03 dhe 04 janë të drejtuara nga rruga dhe regjistrojnë kalimtarët dhe mjetet automobilistike. Në këtë kuadër përpunimi i të dhënave është në tejkallim të qëllimit të përpunimit që është siguria e objektit (referuar nenit 5/1/b të ligjit nr.9887). Kameran duhet të fokusohen vetëm nga fasada e godinës dhe hyrja e kompanisë.

Nga aktet e depozituara nuk rezulton që kontrolluesi të ketë reflektuar mbi këtë konstatim prandaj lind nevoja e marrjes së masave konkrete në kuadër të heqjes së kamerave 01 dhe 02, dhe ripozicionimit të kamerave 03 dhe 04.

- Janë ndërmarrë hapa konkretë nga ana e Kontrolluesit lidhur me referimin e zbatimit të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale (jo atij italian), në përmbajtjen e kontratës së punës me punonjësit, deklaratën e konfidencialitetit dhe aktet e tjera të brendshme.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që e ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë dhe është regjistruar si subjekt tregtar në Regjistrin Tregtar të administruar nga QKR, ka detyrimin ligjor që të respektojë dhe zbatojë legjislacionin vendas, konkretisht Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 31/a/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në aktet e brendshme organizative, aktet që sanksionojnë marrëdhënien me punonjësit dhe aktet lidhur me rregullat e përpunimit të të dhënave personale, të parashikohet qëllimi i mbajtjes së të dhënave të punonjësve për një afat 20 ditor pas përfundimit të marrëdhënies së punës;
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar:
 - Të realizohet informimi i punonjësve (në cilësinë e subjektit të të dhënave personale) mbi masat konkrete të sigurisë që ndërmer kontrolluesi dhe procedurat e përpunimit të të dhënave, në kuadër të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", nëpërmjet parashikimit të dispozitave konkrete në Formularin "E drejta e Informimit dhe Mbrojtjes së të dhënave personale" dhe "Rregulloren e Brendshme";
 - "Politika e privatësisë" e publikuar në faqet e internetit të kontrolluesit, duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të parashikojë dispozita për çdo kategori të dhëne personale dhe çdo subjekt të të dhënave, për të dhënat që përpunohen manualisht dhe për ato që përpunohen elektronikisht. Gjithashtu është e nevojshme që të parashikohen masat konkrete të sigurisë (fizike dhe teknike) që kontrolluesi ndërmer gjatë dhe pas përpunimit të të dhënave.
3. Në kuadër të zbatimit të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08/09.2011 "Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat":
 - Të merren masa konkrete për heqjen e menjëhershme të kamerave 01 dhe 02 të cilat janë të pozicionuara në ambientet e punës së punonjësve, pasi çënojnë privatësinë e punonjësve gjatë ushtrimit të funksionit ose në të kundërt, të merret pëlqimi i shprehur i çdo punonjësi dhe të kryhet informimi i tyre sipas nenit 18 të ligjit nr. 9887. (Bazuar edhe në Udhëzimin nr. 11, datë 08/09.2011 "Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat", pika 10.2 "Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës");
 - Të merren masa konkrete për ripozicionimin e kamerave 03 dhe 04 të cilat janë të drejtuara nga rruga dhe regjistrojnë kalimtarët dhe mjetet automobilistike, pasi përpunimi i të dhënave është në tejkallim të qëllimit, që është siguria e objektit

(referuar nenit 5/1/b të ligjit nr. 9887). Kamerate duhet të fokusohen vetëm nga fasada e godinës dhe hyrja e kompanisë.

4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i këtyre detyrimeve brenda një afati 30 ditor, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi dhe pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë, për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

BESNIK DERVISHI


KOMISIONERI